



# GSRM

## KOMISIONE TË APLIKUARA NGA NDËRMJETËSIT FINANCIAR

**Material Infomues**

**INFORMACIONI MBI KOMISIONET PËR VEPRIMET E LETRAVE ME VLERË QË  
APLIKOHEN NGA TIRANA BANK**

1. Nëse një klient blen letra me vlerë të Qeverisë në tregun primar nëpërmjet Bankës Tirana, komisioni që aplikohet për individët është 0.5% e shumës së investuar (vlera nominale e letrës me vlerë) kurse për klientë jo individë, komisioni që aplikohet është 0.3% e shumës së investuar. Komisioni minimal është 2,000 lekë, ndërsa komisioni maksimal është 5,000 lekë, për të dyja kategoritë e investitorëve.

2. Për shitjen e letrave me vlerë të Qeverisë nga Portofoli i bankës në tregun sekondar, nuk aplikohet komision. Në këtë rast klientit do ti llogaritet çmimi i shitjes së letrës me vlerë të Qeverisë në bazë të yieldit të shitjes të kuotuar nga banka për ditët e mbetura deri në maturim të letrës me vlerë.

**Shembull:**

Një klient do të investojë pranë Bankës Tirana, një shumë 3,000,000 lekë në një Bono Thesari 12 mujore, me ditë të mbetura deri në maturimi 140, duke pasur parasysh që yield-i në shitje i kuotuar nga banka është 6.80%, çmimi i shitjes llogaritet si më poshtë:

$$\text{Çmimi i shitjes} = \frac{3,000,000}{(1 + 6.8\% \cdot \frac{140}{365})}$$
$$\text{Çmimi} = 2,923,742.39 \text{ lekë}$$

3. Në rastin kur klienti dëshiron të shesë një letër me vlerë të Qeverisë, pranë bankës Tirana, para datës së maturimit me ditë të mbetura deri në maturim më shumë se 7, Banka Tirana nuk aplikon komision. Në këtë rast, çmimi i blerjes së letrës me vlerë të Qeverisë do të llogaritet në bazë të yield-it të blerjes të kuotuar nga banka dhe ditëve të mbetura deri në maturim.

Obligacionet e thesarit shiten me premium/discount ndaj vlerës së tyre nominale. Investitori në ditën e blerjes paguan vetëm çmimin e blerjes në përputhje me vlerën nominale dhe normën Yield-in, i cili përcaktohet nga banka. Kuotimet per yieldin e Obligacioneve të thesarit luhaten në varesi të tregut.

**Shembull:**

Nëse një klient do të shesë para afatit të maturimit një Obligacion Thesari me kupon 7.5% që paguhet çdo gjashtë muaj, me 141 ditë të mbetura deri në maturim, me vlerë nominale 1,000,000 lekë, nëse yield-i në blerje që banka ka kuotuar është 6.80%, atëherë çmimi llogaritet si më poshtë:

$$\text{\textit{\textbf{Çmimi i Oblacionit}}} = \frac{K}{2} \left[ \frac{1 - \left(1 + \frac{y}{2}\right)^{-2t}}{\frac{y}{2}} \right] + \frac{VN}{\left(1 + \frac{y}{2}\right)^{2t}}$$

K= Vlera e kuponit =7.5%\*1,000,000 lekë=75,000 lekë

T= vitet e mbetura deri në maturim=141/365=0.3863 vite

Y = yieldi i kuotuar nga banka =6.80%

VN= Vlera Nominale= 1,000,000 lekë

Mbas llogaritjes çmimi i obligacionit do të jetë: 1,002,625.10 lekë.